



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER  
GJIMNAZI “PERIKLI IKONOMI” FIER**

## **RAPORTI VJETOR I SHKOLLËS**

**2023-2024**

## **Realizimi/mosrealizimi i objektivave të planit vjetor dhe shkaqet**

Në përfundim të vitit mësimor 2023-2024 shqyrtohet rezultati i arritur për secilin objektiv të planit vjetor të gjimnazit:

**Objektivi i parë:** “Deri në fund të vitit 2023-2024 të minimizohet në nivelin 3,4% numri i nxënësve të përjashtuar, të larguar në shkolla brenda qytetit ose pa arsye, nga niveli prej 4,3% për vitin 2022-2023. *Nuk llogariten transferimet e nxënësve në shkolla jashtë qytetit apo largimet e dokumentuara jashtë vendit. Llogaritet numri i nxënësve të larguar krahasuar me numrin e nxënësve të shkollës në fillim të vitit shkollor*” është realizuar me sukses, duke e tejkaluar ndjeshëm nivelin e synuar. Nga 447 nxënës në kontingjentin e shtatorit 2023, u larguan për në shkolla të tjera brenda qytetit 2 nxënës, u përjashtuan 6 nxënës, të gjithë për arsye mungesash, ndërsa 3 nxënës rezultojnë se kanë lënë shkollën pa dhënë arsye (njëri prej të cilëve në fund të vitit shkollor). Këta 11 nxënës përbëjnë 2,5% të kontingjentit të fillimit të vitit shkollor. Theksojmë se 2 nxënësit që u larguan në shkolla të tjera brenda qytetit, u transferuan në shkollën industriale “Petro Sota”, me sugjerimin tonë në përgjigje të iniciativës për të fuqizuar arsimin profesional dhe në kuadër të këshillimit të karrierës (ndërsa një nxënës tjetër i transferuar në shkollën industriale “Pavarësia” Vlorë nuk llogaritet më sipër). Pa këtë lëvizje, treguesi i mësipërm do të ishte në nivelin 2%. Nuk ka nxënës të larguar drejt gjimnazeve të tjera brenda qytetit (një vit më parë kjo kategori ishte 2% e kontingjentit të shtatorit 2022). Ky është tregues i përmirësimit të imazhit të shkollës, si institucion arsimor cilësor, ku nxënësit ndihen mirë dhe përmbushin pikësynimet e tyre. E vlerësojmë këtë arritje edhe si rezultat i zbatimit gjatë këtij viti shkollor të projektit “Qëndro në shkollë”, i mbështetur nga qeveria italiane dhe i vënë në jetë nga UNICEF Shqipëria në partneritet me Albanian Social Services Association (ASSA). Me këtë projekt u angazhuan 15 mësues të shkollës, të cilët zhvilluan aktivitete me nxënësit krahas atyre të parashikuara në planin vjetor 2023-2024.

**Objektivi i dytë:** “Në përfundimet e qershorit 2024 niveli i kalueshmërisë së shkollës të rezultojë 95% nga niveli prej 94,4% për vitin 2022-2023. *Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore*”, nuk është realizuar. Nga 425 nxënës në kontingjentin e qershorit 2024, rezultuan kalues të klasës 398 nxënës ose 93,6%. Nga 27 nxënës mbetës, të gjithë për riprovim në 1 ose 2 lëndë për në vjeshtë, 12 prej tyre mbetën në lëndët “Gjuhë shqipe” dhe/ose “Letërsi” të klasës X. Nëntë nxënës të klasës XI mbetën për në vjeshtë në lëndët “Gjeografi” dhe “Gjuhë angleze”, ndërsa 6 maturanë mbetën në vjeshtë në “Gjeografi” dhe “Matematikë”. Kryesisht këta nxënës nuk kaluan klasën në qershor për arsye mungesash 1-2 orëshe gjatë vitit. Frekuentimi dhe ecuria në përgjithësi e nxënësve në këto lëndë do të jenë në qendër të vëmendjes gjatë punës së drejtorisë dhe mësuesve kujdestarë për vitin shkollor 2024-2025.

**Objektivi i tretë:** “Në vitin shkollor 2023-2024 nxënësit tanë të fitojnë 20 vende/çmime të vlerësuara në aktivitetet konkurruese të organizuara nga ose në bashkëpunim me ZVA Fier, nga 18 vende të fituara në vitin 2022-2023. *Në këtë tregues përfshihen edhe vendet fituese të shpallura nga ZVAP Fier në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare*” është realizuar plotësisht. Gjatë vitit shkollor nxënësit e gjimnazit tonë fituan 23 çmime në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare, në konkurse dhe aktivitete konkurruese artistike dhe sportive në nivel lokal.

**Në aspektin financiar** institucioni ynë nuk ka grumbulluar kontribute nga nxënësit dhe prindërit, për arsye të paqartësisë në bazën ligjore për menaxhimin e burimeve të tilla. Nuk ka pasur donatorë të disponueshëm për të kontribuar financiarisht për shkollën gjatë vitit 2023-2024.

**Risi të suksesshme të institucionit** tonë gjatë vitit shkollor ka qenë pjesëmarrja dhe certifikimi i drejtueses dhe një mësueseje të shkollës në trajnimin 22-ditor, programi “Trajnimi i trajnerëve” në kuadër të projektit “EU 4 Inclusive Teaching” i financuar nga Bashkimi Europian, zbatuar nga Universiteti i Tampere, Finlandë. Një grup nxënësish të shkollës sonë u trajnuan në fushën e IT-së, në aktivitetin “YouthCode – Festivali Rinor i Kodimit”, organizuar në Tiranë nga IDM.

### **Bashkëpunimet e suksesshme të institucionit me biznese, institucione dhe OJF**

Gjatë vitit shkollor 2023-2024 janë kontaktuar ish-nxënës të shkollës që kanë planifikuar për vitin e ri shkollor të investojnë në përmirësimin e infrastrukturës digjitale, për të rikthyer në funksion dy laboratorët me projektorë interaktivë, si edhe në rindërtimin e qendrës së memories së shkollës (e cila gjatë vitit u vu në dispozicion si ambient mësimi gjimnazit “K.Vruzhaj”). Shkolla jonë gjatë këtij viti u kualifikua edhe për një rikonstruksion të pjesshëm për të përmirësuar ngrohjen e ndërtesës, projekt që do të jetësohet në vitin 2025. Është bashkëpunuar me IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) në aktivitete për shkollën si qendër komunitare dhe për pjesëmarrjen e nxënësve në trajnimin “YouthCode – Festivali Rinor i Kodimit”.

### **Certifikata, çmime etj., të fituara nga nxënësit e shkollës sonë**

Në aktivitetet sportive të organizuara nga Qendra Kulturore e Bashkisë Fier në bashkëpunim me ZVAP, nxënësit tanë fituan vendet e para për djem dhe vajza, një vend të dytë për djem dhe një vend të tretë për vajza në krosin e vjeshtës 2023, vendin e parë në kampionatin e futbollit, vendin e parë dhe të dytë në kampionatin e shahut (respektivisht për djem dhe vajza), vendin e tretë për djem dhe të katërtin për vajza në kampionatin e volejbollit, dy vende të katërta në kampionatin e basketbollit (për djem dhe vajza). Në Festivalin Teatror për të Rinj – 2024, zhvilluar në qytetin e Fierit, nxënësit tanë u vlerësuan për shfaqjen më të mirë dhe me Çmimin “Hajrie Rondo”. Në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare nxënësit tanë zunë një vend të dytë në letërsi, dy vende të treta në informatikë, dy vende të treta në histori, nga një vend të tretë në histori, letërsi dhe biologji.

**Propozime** për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në IA, në nivel vendor dhe kombëtar.

Në nivel kombëtar, për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe planifikimin e saktë të organikës për vitin shkollor, duhet të përcaktohet me saktësi data kur llogaritet numri i nxënësve me efekt hapjen e klasave, pas së cilës të fillojë procesi i lëvizjeve paralele të detyruara. Ndërsa në nivel vendor duhet të përcaktohen qartë zonat e mbulimit (1 shkollë 9-vjeçare në 1 gjimnaz), ose të lejohen të gjithë nxënësit e qytetit të regjistrohen në të dy gjimnazet.